

VENDIM
Nr.656, datë 25.9.2003

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 pika 1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726. datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:
 - a) "Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale" zëvendësohet me "Departamenti i Administratës Publike".
 - b) Paragrafi i tretë shfuqizohet.
 2. Lidhjet II, "Paga bazë sipas klasave", II/1, "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë" dhe II/M, "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrave, institucioneve të tjera qendrore, ATSH, prefektura dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar", bashkëlidhur vendimit zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe emërtim, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 3. Në lidhjen II-4, "Nivelet e pagës, sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave", të bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:
 - a) Emërtesat "Përgjegjës i teknikës së shumëfishimit", "Përgjegjës ofiçine", "Llogaritar i parë", "Magaznier" dhe "Operator" të paguhen sipas klasës IX të lidhjes II/M.
 - b) Emërtesat "Arkëtar", "Dekorator", "Teknik/fonist", "Teknik mirëmbajtjeje", "Teknik elektrikist", të paguhen sipas klasës VIII të lidhjes II/M.
 - c) Në lidhjen II/M emërtesat të paguhen përkatësisht: "Shofer korrier", sipas klasës VII, "Shofer" sipas klasës VI, "Punëtorë të tjerë" sipas klasës V dhe "Punëtorë pastrimi" sipas klasës IV.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i parashikuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2003 për rritjen e pagave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 16 shtator 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja II/M

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE, ATSH, PREFEKTURA DHE SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

NR.	KLASA	PAGA
1	I	10060
2	II	10600
3	III	11020
4	IV	11770
5	V	12840
6	VI	13550
7	VII	15300
8	VIII	18140
9	IX	19400
10	X	23890

Lidhja II

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE

Nr.	Klasa	Paga
1	I	10060
2	II	10060
3	III	10380
4	IV	10380
5	V	10550
6	VI	10870
7	VII	11190
8	VIII	11600
9	IX	12130
10	X	12870
11	XI	13190
12	XII	14770
13	XIII	17600
14	XIV	20990

Lidhja II/I

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË

Nr.	Klasa	Paga
1	I	10060
2	II	10060
3	III	10380
4	IV	10380
5	V	10760
6	VI	11080
7	VII	11500
8	VIII	12130
9	IX	12660
10	X	12980
11	XI	13500
12	XII	15400
13	XIII	18350
14	XIV	21940

